LEDIA DUSHKU

PRINCIPATA SHQIPTARE DHE QËNDRIMI I GREQISË (MARS-PRILL 1914)

Në prag të mbërritjes së Princit

Pasi diskutoi për një kohë të gjatë çështjen shqiptare, më 29 korrik 1913, Konferenca e Londrës mori vendimin përfundimtar, duke e shpallur Shqipërinë "principatë autonome, sovrane e trashëgueshme, sipas rendit të parëlindjes, nën garancinë e të gjashtë Fuqive. Princi do të caktohej nga të gjashtë Fuqitë"[1]. Tërësia territoriale e shtetit shqiptar do të përcaktohej në terren nga dy Komisione Ndërkombëtare, njëri për vijën kufitare në Veri dhe tjetri për atë në Jug. Pas një pune disamujore, më 17 dhjetor 1913, anëtarët e Komisioni Ndërkombëtar të Kufirit të Jugut, firmosën protokollin mbi kufirin shqiptaro-grek[2]. Protokolli, që mban emrin e qytetit të Firences në të cilin ai u hartua, prezantonte kompromisi e Fuqive të Mëdha, midis kërkesave të shqiptarëve që shkonin tej në Jug dhe atyre greke, të cilat shkonin më në Veri, deri në vijën Himarë-Korçë. Distriktet e Korçës, të Kolonjës, të Përmetit dhe të Gjirokastrës u përfshinë brenda shtetit shqiptar, ndërsa krahina e Çamërisë i kaloi Mbretërisë së Greqisë.

Më 13 shkurt 1914, me anën e një note, Fuqitë e Mëdha njoftuan qeverinë greke për ratifikimin e protokollit të Firences dhe dhënien *de jure*, Greqisë, të pothuajse të gjithë ishujve të Egjeut[3]. Dhurimi përfundimtar i tyre do t'i bëhej asaj vetëm kur trupat grekë të kishin zbrazur ishullin e Sazanit dhe territoret e tjera të pushtuara gjatë Luftës së Parë Ballkanike, të cilat tashmë i ishin njohur Shqipërisë me Protokollin e Firences. Gjithashtu, qeveria greke duhej të angazhohej formalisht për

[1] Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit. Përmbledhje dokumentesh me një vështrim historik (1912-1918),* Vëll. II, Tiranë: "8 nëntori", 1987, f. 278.

[2] *Po aty,* f. 423-426, Teksti i plotë i Protokollit të Firences.

[3] *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), A-VI-39, viti 1913-1914, fl. 170-171. Notë e Fuqive të Mëdha për qeverinë greke, 13 shkurt 1914.

të mos inkurajuar as drejtpërdrejt, as tërthorazi ndonjë rezistencë të çdo natyre qoftë, kundrejt gjendjes së vendosur nga Fuqitë e Mëdha, në Jug të Shqipërisë. Zbrazja do të bëhej shkallë-shkallë. Ajo do të fillonte më 1 mars me krahinën e Korçës dhe ishullin e Sazanit dhe do të përfundonte me atë të Delvinës, më 31 mars 1914.

Më 21 shkurt 1913, pranë kancelarive të Fuqive të Mëdha, mbërriti përgjigjja e Athinës zyrtare, e cila shfaqte gatishmërinë greke për t'u pajtuar me vendimet e Fuqive të Mëdha dhe për të tërhequr trupat e saj nga territoret që i ishin lënë Shqipërisë, brenda kohës së caktuar[4]. Nota deklaronte angazhimin formal për të mos bërë asnjë rezistencë dhe për të mos inkurajuar drejtpërdrejt ose tërthorazi ndonjë rezistencë kundrejt gjendjes së vendosur nga Fuqitë e Mëdha në Jug të Shqipërisë. Krahas angazhimeve, ajo paraqiste edhe disa kërkesa si: rektifikimi i kufijve në luginën e Gjirokastrës, "garancitë e mjaftueshme dhe efikase", për të gjithë popullsinë ortodokse në Shqipëri dhe autonomia për zonën e Himarës.

Ndërkohë, në territoret jugore ishte aktivizuar "Lëvizja Vorioepirote", e cila kundërshtonte vendimin e Fuqive të Mëdha për bashkimin e krahinës së Korçës dhe të Gjirokastrës me shtetin shqiptar. Më 2 mars 1914, aty u shpall "autonomia e Epirit të Veriut" dhe u krijua një qeveri me në krye Jorgo Zografosin (Georgios Zografos), ish guvernator i përgjithshëm i administratës greke në territoret e pushtuara të Shqipërisë së Jugut.

Princi i Shqipërisë - Vilhelm Vidi (Wilhelm Friedrich Heinrich von Wied) dhe dilemat e Greqisë

Më 28 nëntor 1913, ditën e njëvjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Austro-Hungaria dhe Italia deklaruan të zgjedhurin e tyre në postin e princit të Shqipërisë[5]. Ai ishte gjermani i besimit protestant, Vilhelm Vidi. Më 3 dhjetor 1913, sekretari gjerman i Shtetit, Jagov (Gottlieb von Jagow) njoftoi se kandidatura e tij për fronin e Shqipërisë ishte mbështetur edhe nga Fuqitë e tjera. Më 6 shkurt 1914, nëpërmjet një

[4] *AIH*, A-VI-39, viti 1913-1914, fl. 172-175. Notë përgjigje e qeverisë greke dërguar Fuqive të Mëdha, Athinë, 21 shkurt 1914.

[5] Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë: "Kristalina-KH", 2007, f. 56.

shkrese drejtuar gjithë ministrave të Fuqive të Mëdha në Berlin, Vidi pranoi zyrtarisht fronin e Shqipërisë[6].

V. Vidi ishte djali i dytë i një familjeje aristokrate rezidente në qytezën, Neuvied, në atë kohë kapiten në kavalerinë gjermane dhe një nga oficerët më popullorë në Potsdam. Nga gjaku lidhej me familjen mbretërore të Holandës dhe të Rumanisë. Mbretëresha rumune, Eleonora, ishte halla e tij. Lidhje me oborrin mbretëror rumun kishte edhe e shoqja, Sofia[7]. Princi dallohej si njeri i kulturuar, me ndjenjë të fortë të nderit e të detyrës, i ndershëm, me sjellje evropiane, zemërgjerë dhe tolerant, por i dobët dhe i pavendosur. Shpeshherë njerëzit që i qëndronin afër, zemërgjerësinë ia merrnin për dobësi dhe kujdesin për frikë[8]. Me gjithë cilësitë e tij të mira, sipas kajzerit gjerman, Vidit i mungonte zotësia dhe përvoja, cilësi këto të domosdoshme për sovranin e një shteti të ri dhe të rrëmbyeshëm, siç konsiderohej prej tij, Shqipëria[9]. Princi ishte pa përvojë në intriga dhe diplomaci, dinte pak për çështjet e Ballkanit dhe besonte në vullnetin e mirë të Fuqive të Mëdha[10]. Kishte një vizion tepër të lartë për rolin e vet, por në të vërtetë ai nuk ishte dhe as u mundua që të ishte një kryetar shteti energjik e karizmatik[11].

Pas një turi diplomatik në kryeqytetet kryesore evropiane, më 7 mars 1914, princ Vidi, i shoqëruar nga e shoqja, mbërriti në Durrës, me vaporin austriak "Taurus". Po në të njëjtën ditë, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit i dorëzoi atij pushtetin që e kishte ushtruar deri në atë kohë në rrugë të jashtëzakonshme, duke u kthyer në rolin e tij të zakonshëm, që konsistonte në "përfundimin e Statutit Organik të Shqipërisë dhe përpunimin e organizimit të brendshëm"[12].

---

[6] *AIH*, A-IV-66, *Kujtimet e princ Vidit*, fl. 11.

[7] D. Heaton Armstrong, *Shqipëri-1914. Gjashtë muaj Mbretëri*. (Kujtimet e sekretarit të Princ Vidit), Tiranë: Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, 2001, f. 7.

[8] *Po aty*, f. 134.

[9] *AIH*, A.VI.39, viti 1913-1914, fl. 144, Raport i ambasadorit të Britanisë së Madhe në Berlin për ministrin e Jashtëm, Grej (Edward Grey), Berlin, 5 qershor 1914.

[10] Joseph Swire, *Ngritja e një mbretërie,* Tiranë: "Dituria", 2005, f. 165-166.

[11] Ferdinando Salleo, *Shqipëria: gjashtë muaj mbretëri*, Tiranë: Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, 2001, f. 157.

[12] *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSt.A.PA.A.)* në *AIH*, Vj. 24-42-4221. Vështrim historik, përpunuar nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, Vlorë: 18 prill 1914; *Ministere des Affaires*

Ecuria e çështjes së princit të Shqipërisë vuri në lëvizje edhe diplomacinë greke. Kishte dy arsye që e kushtëzonin qëndrimin e saj ndaj çështjes së Vidit.

Së pari, qëndrimi i Fuqive të Mëdha. Deri në momentin kur Vilhelm Vidi nuk ishte deklaruar ende si kandidaturë e përbashkët e tyre, Greqia nuk u tregua aktive në deklarata për çështjen e princit të Shqipërisë. Nga burime jogreke, bëhet me dije se ajo nën zë e kundërshtonte kandidaturën e Vidit si princ i Shqipërisë[13]. Arsyeja, mendoj që lidhej me faktin se, ai mbështetej vetëm nga dy Fuqitë e Adriatikut. Në momentin që Vidi u pranua nga të gjitha Fuqitë e Mëdha, pra, doli nga kuadri i mbështetjes austro-italiane, Greqia kishte pak shanse për ta kundërshtuar. Përgjithësisht, qeveria greke tregonte kujdes për të manifestuar bindje ndaj vendimeve unanime të Fuqive të Mëdha[14].

Arsyeja e dytë, lidhet me zhvillimet politike në Ballkan dhe qëndrimet që homologët ballkanikë kishin deklaruar rreth Vidit e Principatës Shqiptare. Në fillim të vitit 1914 vihet re një intensifikim i përpjekjeve të shteteve ballkanike për një politikë të përbashkët në rajon. Në fund të janarit, krerët e qeverive ballkanike bënë vizita në Peterburg dhe Bukuresht. Qëllimi i tyre kryesor i shërbente realizimit të një "marrëveshjeje formale mes Serbisë, Rumanisë e Greqisë, e cila do të përfshinte direktivat e përgjithshme të politikës së mëtejshme jo vetëm kundrejt rrezikut turko-bullgar, por edhe përkundrejt Shqipërisë dhe Austro-Hungarisë"[15]. Ajo çka u diskutua në të dy kryeqytetet sigurisht që gëzonte aprovimin e drejtpërdrejtë të Rusisë.

Çështjet e mësipërme u bënë pjesë e diskutimeve mes kryeministrit serb, N. Pashiç (Nikola Pašić), dhe atij grek, E. Venizelos (Eleftherios Venizelos), edhe gjatë vizitës së këtij të fundit në Beograd, në mes të shkurtit të 1914. Pashiçi ishte i mendimit se, marrëveshjet e veçanta të viteve 1912-1913, mes shteteve ballkanike, tashmë duhet të ktheheshin

---

Etrangéres, Archives Diplomatiques (më tej: *AMAE*) në *AIH*, F. 150, fl. 731-738, Aneks i letrës së delegatit francez në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, Vlorë: 15 prill 1914.

[13] *HHSt.A.PA.A.* në *AIH,* Vj. 23-6-678, Telegram nga Sinaia për ministrin e Jashtëm në Vjenë, Sinaia, 6 nëntor 1913.

[14] Basil Kondis, "The autonomous government of Northern Epirus and the revolt in central Albania in 1914" në *Balkan Bibliography,* Vol. IV, Viti 1975, f. 114.

[15] *AIH*, A-VI-39, fl. 181-185, Raport i ambasadorit britanik në Beograd për ministrin e Jashtëm, Grej, Beograd, 11 shkurt 1914.

në një marrëveshje të përbashkët shumëpalëshe[16]. Interesat serbë, grekë dhe rumunë duhet të identifikoheshin dhe politika e tri Fuqive Ballkanike të merrte të njëjtin drejtim. Po shkohej kështu sërish drejt një Antante të shteteve ballkanike nën dirigjimin e Rusisë. Vendosja e raporteve të afërta mes shteteve ballkanike ishte një sinjal pozitiv për ruajtjen e *status quo-së* në territorin e njohur si Maqedoni dhe një aleancë efikase kundër Bullgarisë e Perandorisë Osmane[17].

Njëra prej çështjeve që u dilte përpara tri Fuqive Ballkanike ishte qëndrimi që ato do të mbanin ndaj kandidaturës së Vidit dhe shtetit shqiptar. Ndër to, rolin e protagonistit e mori Rumania. Kjo jo rastësisht. Si për shkaqe familjare, ashtu edhe politike, interesat rumunë shkonin në mbështetje të Vidit dhe Shqipërisë[18]. Në atë fillim viti, aleati lindor i Austro-Hungarisë ishte kthyer kah Rusia dhe në çdo moment mund ta shpallte veten kundërshtar të Trepalëshit[19]. Marrëdhëniet e mira me Shqipërinë jepnin më shumë garanci për paqen në Ballkan dhe zvogëlonin ndikimin e Austro-Hungarisë dhe të Italisë në rajon. Shpejt politika rumune u mbështet nga Serbia, e cila nuk vonoi të deklaronte se, kishte hequr dorë plotësisht prej qëllimeve agresive ndaj Shqipërisë dhe se ushqente dëshirën për të përkrahur prosperitetin e një Shqipërie të lirë dhe të pavarur nën sovranitetin e princ Vidit[20]. Një Shqipëri e pavarur dhe mike, kishte për të, kuptimin e qetësisë në kufijtë jugorë dhe jugperëndimorë. Kryeministri Pashiç siguroi përfaqësuesin rumun në Beograd se, qeveria e tij ka vendosur të jetë në marrëdhënie të mira me qeverinë e re shqiptare, me kusht që ajo të garantojë qetësinë e kufirit dhe të nxitojë t'i japë dalje tregtare në Adriatik, premtim ky i bërë nga Konferenca e Londrës[21]. Politika serbe karshi Shqipërisë nuk ishte në kundërshtim me interesat rumunë, atje. Por, të dy palëve nuk u interesonte një zmadhim i mëtejshëm i Greqisë në Shqipërinë e Jugut,

[16] *Po aty.*

[17] *Po aty*, fl. 180-181, Raport i ambasadorit britanik në Beograd për ministrin e Jashtëm Grej, Beograd, 1 shkurt 1914.

[18] *Po aty*.

[19] Norman Rich, *Diplomacia e Fuqive të Mëdha (1814-1914),* Tiranë: "Toena", 2006, f. 437.

[20] *AIH*, A-VI-39, fl. 181-185, Raport i ministrit britanik në Beograd për ministrin e Jashtëm, Grej, Beograd, 11 shkurt 1914.

[21] *AMAE* në *AIH*, F. 149, fl. 88-90, Raport i ministrit të Francës në Beograd për Ministrinë e Jashtme të Francës, Beograd, 9 mars 1914.

sidomos pas zmadhimeve që ajo kishte fituar në kurriz të Bullgarisë pas Luftës së Dytë Ballkanike[22]. Ky zmadhim do të shtonte oreksin grek për të kërkuar më shumë në Maqedoni. Rumania nuk e dëshironte zmadhimin e Greqisë në krahinat jugore shqiptare edhe për një arsye të dytë. Ajo i trembej helenizimit në kohë të elementit vlleh, që banonte në zonat e mësipërme[23]. Mbreti i Rumanisë, Karol, me kohë mbështeste projektin për t'i përfshirë vllehtë e Pindit dhe Gramozit brenda shtetit shqiptar[24].

Në këtë situatë, Rumania mori përsipër rolin e ndërmjetësit me Greqinë në lidhje me Shqipërinë. Roli pozitiv që qeveria rumune po luante në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve greko-osmane pas rishfaqjes së rrezikut osmano-bullgar, i jepte asaj besim për të ndërmjetësuar pranë qeverisë greke edhe në rastin e princit dhe të ardhmes të shtetit shqiptar. Në Peterburg dhe Bukuresht, kryeministri rumun e kishte këshilluar në mënyrë energjike Venizelosin të tërhiqej nga territoret e pushtuara në Shqipërinë e Jugut, "pa shkaktuar ankime"[25] dhe të mbante relacione të mira me Shqipërinë[26]. Mbështetja që Serbia i kishte dhënë politikës rumune në lidhje me Vidin, të bën të mendosh se, rekomandime të njëjta Venizelosi duhet të ketë marrë edhe nga homologu serb.

Këshilla rumune nuk kishte gjasa të kalonte pa lënë gjurmë te qeveria greke. Kreu i saj i jepte rëndësi miqësisë me Rumaninë[27]. Ajo ishte e rëndësishme për Greqinë, sepse bashkëpunimi greko-rumun konsiderohej si mbrojtës kundrejt qëndrimit armiqësor që mbanin në atë kohë Perandoria Osmane dhe Bullgaria. Nga ana tjetër, Princi i porsazgjedhur i Shqipërisë, ishte nip i mbretëreshës së Rumanisë, ndikimi i së cilës tek ai

[22] Në marrëveshjen e Bukureshtit të gushtit 1913, e cila finalizoi Luftën e Dytë Ballkanike, territoret e Greqisë u zgjeruan veçanërisht përgjatë bregdetit të Egjeut duke përfshirë edhe Kavallën, një qytet-port i rëndësishëm. Shih: N. Rich, *Diplomacia e Fuqive...,* f. 431.

[23] *AIH*, A-VI-39, fl. 181-185, Raport i ambasadorit britanik në Beograd për ministrin e Jashtëm, Grej, Beograd, 11 shkurt 1914.

[24] Timo Dilo, "Çështja shqiptare në Konferencën e Londrës", në: *Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, Tiranë: "Mihal Duri", 1962, f. 249.

[25] Timo Dilo, *Invazionet greke në Shqipërinë e Jugut*, dorëshkrim në *AIH*, A-IV-330, fl. 56.

[26] *HHSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-7-758, Raport i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Romë për Ministrinë e Jashtme, Romë, 12 mars 1914.

[27] *Po aty.*

deklarohej të ishte i madh. Sipas konstatimeve të kohës, Vidi dhe, për më tepër e shoqja, Sofia, ndikimi i së cilës ishte i dukshëm tek i shoqi, notonin krejtësisht në ujërat rumune[28]. Kështu që, marrëdhëniet miqësore me Rumaninë, i shërbenin Greqisë edhe në konsolidimin e pozitave të saj në Shqipëri. Përfaqësuesi grek në Beograd, i kishte lënë të kuptohej homologut të tij francez se, "qeveria e tij kishte gjithë interesin e saj që të jetonte në marrëdhënie të mira me shtetin e ri, në qoftë se ky i fundit nuk kishte ndonjë kundërshtim t'u jepte epirotëve një pjesë të përshtatshme të autonomisë"[29]. Grekët nuk e shihnin me sy të keq instalimin e ngadalshëm të regjimit të ri aty, sepse e parashikonin të dobët e të ngathët. Greqia druhej se, nëse Princi refuzonte të shkonte në Shqipëri, Fuqitë e Mëdha do të ishin të detyruara të ndërmerrnin veprime që do të dëmtonin interesat grekë aty[30]. Për momentin, ata i trembeshin një ndërhyrjeje ushtarake të Fuqive të Trepalëshit në Shqipërinë e Jugut[31].

Druajtja greke u përforcua edhe nga nëpunës të Ministrisë së Jashtme franceze. Në fillim të marsit 1914, ambasadori francez në Berlin, e këshilloi homologun e tij grek se "tanimë që krijimi i Shqipërisë ishte një fakt i kryer, ishte e tepërt të ngrije zërin e të kundërshtoje për oportunitetin më të madh a më të vogël të atij krijimi... .Nëse sot faktet tregojnë pafuqinë e qeverisë shqiptare, pasoja do të ishte një pushtim i vendit. Qeveria e Romës nuk do ta ketë të vështirë të pushtojë Vlorën, ndërsa ajo e Vjenës të vendoset në Durrës. Që nga ajo ditë, shpresat që mund të kenë nacionalistët e Athinës do të ndërpriteshin në mënyrë të prerë. Interesi i Greqisë është që të presë çastin e volitshëm dhe mos t'i përshpejtojë ngjarjet që sot domosdoshmërish mund të ktheheshin kundër saj"[32].

Për Greqinë, Shqipëria nuk duhej të bëhej fusha e mbyllur e rivalitetit austro-italian, ajo duhej mbyllur ngushtësisht në gjirin ballkanik. Një Shqipëri e mbështetur në mënyrë solide nga shtetet ballkanike, do të ishte

---

[28] *Po aty*, Vj. 23-3-383, Letër e Eqrem Vlorës për Konsullin e Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, A. Rappaport, Berlin, 12 dhjetor 1913.

[29] *AMAE* në *AIH*, F. 149, fl. 88-90, Raport i ambasadorit të Francës në Serbi për ministrin e Jashtëm të Francës, Dumerg, Beograd, 9 mars 1914.

[30] V. Duka, *Histori e Shqipërisë...,* f. 58.

[31] F. Salleo, *Shqipëria:* gjashtë..., f. 59.

[32] *AMAE* në *AIH*, F. 149, fl. 200-201, Raport i ambasadorit të Francës në Berlin për ministrin e Jashtëm, Berlin, 15 mars 1914.

më e lehtë për t'u shkëputur nga ndikimet austro-italiane[33]. Ky qëndrim mbështetej edhe nga shtetet e tjera ballkanike. Qeveria serbe e shikonte me mosbesim të madh politikën austro-italiane ndaj Shqipërisë. Ajo ishte e bindur se, Italia dhe Austro-Hungaria do të bënin çdo gjë për ta mbajtur atë brenda sferës së influencës së tyre[34]. Në këtë situatë, Vidi duhej mbajtur afër për të mos qenë i gatshëm të bëhej vegël e kësaj politike. Sakaq, Oborri i Rumanisë kishte vepruar pranë Princit. Ai i kishte rekomanduar atij që të çlirohej nga çdo mbrojtje "kujdestarie" e Austro-Hungarisë dhe Italisë dhe të ishte shumë i disponuar të lidhte marrëdhënie të mira me Greqinë dhe Serbinë[35].

Për të gjitha sa më sipër, prononcimet publike të zyrtarëve të lartë grekë shprehnin dëshirën për mbërritjen sa më shpejt të Princit në Durrës. Deklarata e parë publike greke u bë në fund të janarit të vitit 1914. Në audiencën e organizuar prej Vidit, në prag të pranimit zyrtarisht të fronit të Shqipërisë, kryeministri grek deklaroi hapur dëshirën e tij që, Princi të arrinte sa më shpejt të ishte e mundur në Shqipëri[36]. Venizelosi kishte dalë me përshtypje të mira prej takimit me Princin e Shqipërisë, ndonëse ai kishte qenë tejet i shkurtër dhe thjeshtësisht një akt kortezie. Sipas ambasadorit të Francës në Athinë, kishte gjasa që Vidi të ishte treguar tolerant ndaj një korrigjimi të mundshëm të kufirit shqiptaro-grek, gjë kjo e dëshiruar nga kryetari i qeverisë greke[37].

Më 2 mars 1914, me ndërmjetësinë e ministrit të Austro-Hungarisë në Berlin, kryeministri dhe ministri i Jashtëm grek, njoftuan Pricin se, për shkak të rrethanave epirote, e konsideronin të domosdoshëm hipjen e tij

[33] *Po aty*, fl. 88-90, Raport i ambasadorit të Francës në Serbi për ministrin e Jashtëm të Francës, Dumerg, Beograd, 9 mars 1914.

[34] *AIH*, A-VI-39, fl. 181-185, Raport i ambasadorit britanik në Beograd për ministrin e Jashtëm, Grej, Beograd, 11 shkurt 1914.

[35] *AMAE* në *AIH*, F. 148, fl. 1500, Telegram i ambasadorit të Francës në Athinë për ministrin e Jashtëm të Francës, Dumerg, Athinë, 23 shkurt 1914; AMAE në AIH, F. 149, fl. 88-90, Raport i ambasadorit të Francës në Serbi për ministrin e Jashtëm të Francës, Dumerg, Beograd, 9 mars 1914.

[36] *HHSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-1-152, Raport i këshilltarit të Vidit, austro-hungarezit Buhberger (Buchberger) për konsullin e përgjithshëm në Ministrinë e Jashtme të Austro-Hungarsië, A. Rappaportin, në lidhje me audiencën e organizuar nga Princi, Berlin, 1 shkurt 1914.

[37] *AMAE* në *AIH*, F. 148, fl. 1500, Telegram i ambasadorit t të Francës në Athinë për ministrin e Jashtëm të Francës, Dumerg, Athinë: 23 shkurt 1914.

në fron[38]. Menjëherë, edhe mbreti i Greqisë, Kostandini deklaroi se do ta njihte atë si Princ të Shqipërisë, duke i dërguar përshëndetjet e tij, sapo ai të mbërrinte në Durrës[39]. Me të mbërritur Vidi në Durrës, Greqia paraqiti letrat kredenciale[40]. Në mes të marsit, princ Vidi dhe mbreti Kostandin shkëmbyen telegramet e rastit[41].

Greqia dhe angazhimet ndaj Fuqive të Mëdha

Më 5 mars 1914, në seancën e radhës të Dhomës së Deputetëve në Parlamentin grek, kryeministri Venizelos deklaroi se, Greqia duhej t'i nënshtrohej vendimit të Fuqive të Mëdha në lidhje me kufijtë e Shqipërisë, përderisa ajo dhe shtetet e tjera ballkanike me traktatin e nënshkruar në Londër në maj të një viti më parë, ua kishin besuar atyre zgjidhjen e kësaj çështjeje. Zbatimi i kushteve të vëna nga Fuqitë e Mëdha në notën e 13 shkurtit 1914, konsiderohej prej tij se, kishte një rëndësi të madhe, dhe Greqia ishte e detyruar të respektonte afatet e vendosura prej saj në lidhje me tërheqjen e ushtrisë[42]. Në lidhje me "ata që luftonin në Epir", kreu i qeverisë greke u shpreh se, "popullsia greke e përfshirë në shtetin shqiptar, duhet t'u nënshtrohet vendimeve të Evropës. Qëndresa e tyre në asnjë mënyrë nuk do të mund të mbështetej nga Greqia. Një gjë e tillë do të shkaktonte pasoja të mynxyrshme për vetë popullsinë që ka bërë kryengritje dhe do të godiste interesat e përgjithshëm të kombit helen"[43].

Deklaratat e mësipërme, të lënë të kuptosh se, Athina zyrtare formalisht ishte e angazhuar për të përmbushur detyrimet e saj ndaj Fuqive të Mëdha, duke tërhequr brenda afateve ushtrinë e saj nga territoret e shtetit shqiptar dhe duke mos mbështetur "Lëvizjen Vorioepirote". Besnikëria ndaj notës së të Mëdhenjve ishte një kusht paraprak edhe për pranimin e kërkesave që ajo i kishte bërë atyre, në notën e 21 shkurtit. Qeveria greke shprehte bindje se, sapo Fuqitë e

[38] *AIH*, A-IV-66, *Kujtimet e princ Vidit*, fl. 11.

[39] Arben Puto, *Pavarësia e Shqipërisë dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha*, Tiranë: "8 nëntori", 1978, f. 584.

[40] J. Swire, *Shqipëria: Ngritja e një...,* f. 167.

[41] *AIH*, A-IV-164, Kalendari i ngjarjeve në Shqipëri, fl. 2.

[42] *AMAE* në *AIH*, F. 149, fl. 52-53, Notë e Legatës greke në Paris për Ministrinë e Jashtme franceze, Paris, 6 mars 1914. Mbi seancën e dhomës së deputetëve të Parlamentit grek.

[43] *Po aty.*

Mëdha të ishin në gjendje t'i përgjigjeshin notës së saj, ato do ta bënin atë pa hezitim, duke pranuar kërkesat që ajo kishte parashtruar. Shpresohej se, përgjigjja do t'u njihte territoreve jugore të shtetit shqiptar, karakterin e pretenduar grek.

Për të gëzuar simpatinë dhe mbështetjen e Fuqive të Mëdha, qeveria greke u kujdes ta vinte menjëherë në pah angazhimin e saj për përmbushjen e kushteve të vëna prej tyre. Më 1 mars 1914, ajo filloi tërheqjen e ushtrisë nga Korça, ndërkohë që filloi përgatitjet për tërheqjen edhe nga zonat e tjera. Të nesërmen, forcat e xhandarmërisë shqiptare nën varësinë e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit dhe komandën e Mustafa Aranitasit hynë në Korçë, ku u pritën si çlirimtarë[44]. U krijua përshtypja se ushtria greke do të largohej paqësisht dhe shpejt nga territoret shqiptare, duke krijuar premisa pozitive në marrëdhëniet me Shqipërinë.

Qeveria greke tregoi kujdes edhe në qëndrimin ndaj qeverisë së Zografosit dhe "Lëvizjes Vorioepirote". Sakaq, kryetari i saj i bëri me dije prefektit të Korfuzit se "autoritetet tona nuk dëshirojnë t'i njohin asnjë veçanti autoritare, Qeverisë Zografos, as atë vetë nuk e njohim si kryetar të qeverisë së përkohshme; po ashtu, do të sillemi ndaj tij si ndaj një qytetari të përveçëm, pa përdorur mjete dhune, por duke mos lejuar, nga ana tjetër, krijimin dhe konsolidimin e autoriteteve të reja administrative nën qeverinë e përkohshme dhe duke respektuar funksionet e autoriteteve tona deri në çastin e zbrazjes [së Epirit]"[45]. Po ashtu Venizelosi udhëzoi komandantin Papulas (Anastasios Papoulas), të ngarkuar prej tij për të siguruar evakuimin e trupave grekë nga Shqipëria, që të hynte në bisedime me oficerët holandezë dhe të përshpejtonte dorëzimin e Korçës e të Leskovikut, përpara se kryengritja të përhapej edhe atje[46]. Duke dashur të tregonte se nuk e inkurajonte dhe ndihmonte Lëvizjen në Jug, qeveria greke mori masa, të cilat në një kohë të shkurtër u panë se ishin sporadike dhe të përkohshme. Më 7 mars 1914, luftanijet

[44] V. Duka, *Histori e Shqipërisë...,* f. 64.

[45] *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου και Ελληνοαλβανικές Σχέσεις* (Grekët e Epirit të Veriut dhe marrëdhëniet greko-shqiptare) Επιμέλεια: Βασίλειος Κόντης (nën kujdesin e Vasil Kondis) Έγγραφα από το Ιστορικό Αρχείο του Υπουργείου Εξωτερικών (Dokumente nga Arkivi Historik i Ministrisë së Jashtme) Τόμος I, 1897-1918 (Vëllimi I, 1897-1918) Εστιασ: Αθήνα, 2004, fl. 321-322, Venizelosi për prefektin e Korfuzit, Athinë, 15\28 shkurt 1914.

[46] *Po aty*, fl. 329, Venizelosi për Papulasin, Athinë, 20 shkurt / 5 mars 1914.

e armatës greke "Alfios" dhe "Evrotas" bllokuan portin e Sarandës. Po atë ditë, qeveria greke u komunikoi Fuqive të Mëdha, veprimin e ndërmarrë[47]. Në komunikatë, sqarohej se "vendimi merrej në përputhje me detyrimet e marra prej saj dhe me kujdesin e arsyeshëm për të ruajtur rendin deri në zbrazjen e vendeve, që u gjykuan t'i jepeshin Shqipërisë"[48]. Me bllokimin e portit, qeveria greke pretendonte se i jepte një grusht të fortë "Lëvizjes Vorioepirote"[49], duke evituar veprimet e tepruara nga ana e kryengritësve kundër anijeve që hynin në port, gjë që mund të shkaktonte ndërlikime ndërkombëtare[50].

Bllokimi i portit të Sarandës ishte një lëvizje e menduar e qeverisë greke. Për ministrin e Jashtëm italian, bëhej fjalë për një "komedi të vogël" nga ana e saj. Bllokimi i portit konsiderohej të ishte një masë afatshkurtër, në kushtet kur, qeveria greke pretendonte se, disa nga "Fuqitë e Mëdha do ta ndienin atë si jo të këndshme për lundrimin e tyre duke kërkuar heqjen e saj"[51]. Për kryediplomatin austro-hungarez në Janinë, bllokada në realitet nuk kishte asnjë qëllim konkret. Ajo ishte sërish një manovër e Greqisë para syve të Evropës, që dëmtonte çdo gjë tjetër, por jo qeverinë autonome të Zografosit[52]. Furnizimet nga Greqia dërgoheshin kryesisht në rrugë tokësore me ndërmjetësinë e autoriteteve greke të pushtimit.

Në këtë kohë, qeveria greke ndaloi edhe mbajtjen e mitingjeve në Athinë dhe Pire, të njoftuara nga mbështetësit e "Lëvizjes Vorioepirote"[53]. Në faqet e shtypit të kohës, evidentohej se, ishte rasti i parë që në Greqi

[47] *AMAE* në *AIH*, F. 151, fl. 990-991, Notë e Legatës greke në Paris për Ministrinë e Jashtme franceze, Paris, 29 prill 1914.

[48] *AIH,* A-IV-212, Kostandin Skënderis, *Lufta për Epirin e Veriut në vitin 1914,* Athinë, 1930 (C. Σκενδέρης, *Ο Βορειοηπειρωτικός αγών 1914*, Athens: 1930), fl. 54. Komunikatë e qeverisë greke, Athinë, 7 mars 1914.

[49] *HHSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-7-734, Telegram i legatës së Austro-Hungarisë në Athinë për Ministrinë e Jashtme, Athinë, 7 mars 1914. Mbi takimin me ministrin e Jashtëm grek, Streit.

[50] *AIH*, A-IV-212, fl. 54. Komunikatë e qeverisë greke, Athinë, 7 mars 1914.

[51] *HHSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-7-751, Telegram i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Romë për ministrin e Jashtëm, Romë, 8 mars 1914. Mbi takimin me ministrin e Jashtëm italian.

[52] *Po aty*, Vj. 24-7-762, Raport i Konsullatës së Austro-Hungarisë në Janinë për Ministrinë e Jashtme, Janinë, 15 mars 1914.

[53] *AIH*, A-V-212, fl.73-74. Urdhër i policisë së Athinës për të ndaluar mbajtjen e mitingjeve në Athinë dhe Pire.

ndalohej mbajtja e mitingjeve të tilla[54]. Venizelosi bllokoi edhe depozitën prej 300.000 frangash që "epirotët kishin mbledhur në mbështetje të kauzës së tyre"[55].

Edhe qeveria e vetëshpallur e Vorio-Epirit u kujdes për ta deklaruar larg vetes qeverinë greke. Në notën që Zografosi i dërgoi Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit në Durrës, më 2 mars 1914, nënvizonte se, Greqia nuk kishte të drejtë të ndërhynte në punët e tyre. Sapo të mbaronte afati i pushtimit, ajo duhej të largohej. Tokat që do të zbrazeshin prej saj, do të ishin pjesë e shtetit të ri autonom[56]. Ata nuk e njihnin sovranitetin e shtetit shqiptar dhe e konsideronin akt armiqësor hyrjen e trupave shqiptarë në "Epir"[57]. I shpejtë ishte reagimi i Zografos edhe për bllokimin e portit të Sarandës. Ai protestoi pranë qeverisë greke për veprimin në fjalë, duke e konsideruar atë mospjesëmarrëse në Lëvizje, por jo kundërshtare të saj[58]. Me anën e një qëndrimi të tillë, synohej të ndikohej në opinionin publik grek dhe më gjerë për fatin e një popullsie që luftonte e vetme dhe pa mbështetje për të mos rënë në duart e shqiptarëve dhe të bëhej presion te Fuqitë që të rishikohej edhe një herë kufiri në një kuptim më të favorshëm për interesat grekë[59].

Tërheqja e ushtrisë greke nga territoret e Shqipërisë së Jugut: farsë apo realitet

Vazhdimi i "Lëvizjes Vorioepirote" në Shqipërinë e Jugut shkaktoi shqetësim dhe impenjim në qeverinë e sapokrijuar shqiptare. Shqetësimi u rrit, edhe sepse tërheqja e ushtrisë greke nga territoret shqiptare po shfaqte çdo ditë e më shumë probleme. Përshtypja e krijuar ditët e para të marsit për tërheqjen e shpejtë dhe pa incidente të ushtrisë greke nga territoret shqiptare, nuk kishte më vend. Greqia po e zvarriste qëllimisht këtë proces. Për sa kohë trupat e saj ishin në territorin shqiptar, "Lëvizja Vorioepirote" inkurajohej dhe forcohej. Forcimi i saj rëndonte gjendjen

[54] Edith Stickney, *Shqipëria Jugore ose Epiri i Veriut në çështjet evropiane ndërkombëtare, 1912-1923,* Tiranë: "Koha", 1998, f. 78.

[55] *AIH*, A-VI-39, viti 1913-1914, fl. 130, Raport i ambasadorit të Britanisë së Madhe në Athinë për ministrin e Jashtëm, Athinë, 5 mars 1914.

[56] V. Duka, *Histori e Shqipërisë...,* f. 64.

[57] F. Salleo, *Shqipëria:* gjashtë..., f. 70.

[58] *AIH*, A-IV-212, f. 54-55. Protestë e J. Zografos për qeverinë greke, Gjirokastër: mars 1914.

[59] A. Puto, *Pavarësia e Shqipërisë...,* f. 561.

në Jug, bënte jo ekzistent autoritetin e qeverisë shqiptare atje, duke rritur në të njëjtën kohë presionin, si pranë saj edhe te Fuqitë e Mëdha, për ta njohur qeverinë e Zografosit si autoritet dhe palë në bisedime. Nëse një gjë e tillë realizohej, Greqia kishte mundësi të shpresonte në sigurimin e lirive të dëshiruara për "epirotët", madje edhe përtej tyre, në rektifikime të kufirit me Shqipërinë[60].

Qëndrimi i ushtrisë greke në territoret e shtetit shqiptar motivohej edhe nga ecuria e çështjes së ishujve të Egjeut, dy çështje këto të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën nga Fuqitë e Mëdha në notën e 13 shkurtit 1914. Për sa kohë Perandoria Osmane kundërshtonte vendimin e Fuqive të Mëdha për ishujt e Egjeut[61], Greqia synonte ta përdorte qëndrimin e ushtrisë së saj në territoret shqiptare si mjet presioni ndaj Fuqive për të bindur Perandorinë Osmane të tërhiqej. Por, duke mos tërhequr ushtrinë nga territoret e Shqipërisë së Jugut, Greqia nuk respektonte kufirin jugor të shtetit shqiptar, i vendosur dhe i garantuar nga Fuqitë e Mëdha, duke acaruar marrëdhëniet me Shqipërinë.

Informacioni nga terreni tregonte se, nga administrata ushtarake greke nuk po bëhej një dorëzim i rregullt i krahinave, në drejtim të xhandarmërisë shqiptare. Sikurse kishte ndodhur shpesh herë në marrëdhëniet mes dy fqinjëve, deklaratat dhe realiteti nuk ishin e njëjta gjë. Drejtori i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme, informonte qeverinë shqiptare për veprime të kryera "nga banda të armatosura, nga disa njësi të batalioneve lokale dhe me sa duket edhe nga ushtarë dhe oficerë të ushtrisë së rregullt greke"[62].

Në distriktin e Përmetit, boshatisur zyrtarisht nga trupat grekë, një pjesë e fshatrave ishin ripushtuar, me pretekstin se banorët ortodoksë nuk donin as t'i dorëzonin armët, as t'u nënshtroheshin autoriteteve shqiptare[63]. Kapitenë të artilerisë greke, të shoqëruar nga ushtarë "të

---

[60] *HHSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-14-1453, Raport i atasheut ushtarak të Marinës së Austro-Hungarisë në Athinë për shefin e Shtabit të Përgjithshëm, Athinë, 10 prill 1914.

[61] N. Petsalis-Diomidis, *Greece at the Paris Conference of Paris,1919*, Thessaloniki: Institute for Balkan Studies, 1978, f. 30.

[62] *HHSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-41-4172, Raport i këshilltarëve të kabinetit të Vidit, Buhberger dhe Kastoldi (Castoldi) për ministrin e Jashtëm austriak dhe atë italian, Durrës, 14 mars 1914.

[63] *Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH),* Fondi (më tej: F.) 694 (Vilhelm Vidi), viti (më tej: V.) 1914, dosja (më tej: D.). 246(6), fl. 4,

quajtur dezertorë, kishin marrë pjesë në demonstratat kryengritëse të popullsisë"[64]. Nën pretekstin e "parandalimit të kryengritjes nga popullsia ortodokse", të gjitha fshatrat në jug të Qafës së Kiçokut ishin ripushtuar nga ushtarët grekë, detashmentet e të cilëve ishin përqendruar kryesisht në fshatrat myslimane[65]. Në distriktin e Kolonjës, edhe ky i dorëzuar rregullisht nga trupat grekë, "disa banda të përforcuara nga ushtarë grekë të maskuar", kishin nxitur popullsinë për kryengritje dhe kishin terrorizuar banorët shqiptarë myslimanë[66]. Në Frashër, fshat i boshatisur zyrtarisht nga ushtria greke, komandanti shqiptar kishte marrë një letër kërcënimesh nga koloneli i dezertuar i ushtrisë greke, Varda, në të cilën u kërkohej shqiptarëve braktisja e qytetit[67].

Vihej re një komunikim i veçantë midis ushtrisë greke dhe trupave autonomistë, i cili të krijon përshtypjen se këta të fundit ishin në dijeni të lëvizjeve të ushtrisë greke. Fill pas largimit të ushtrisë greke, zonat e zbrazura okupoheshin menjëherë prej autonomistëve[68]. Kjo mënyrë nxiste konfliktin e armatosur mes shqiptarëve, që duhet t'i merrnin në dorëzim krahinat, dhe "epirotëve" që realisht i kishin okupuar ato.

Telegram i Drejtorit të Përgjithshëm të Punëve të Brendshme, Fejzi Alizoti, për princ Vidin, 11 mars 1914.

[64] *AQSH*, F. 694, V. 1914, D. 246(6), fl. 6-7, Telegram i drejtorit të Përgjithshëm të Punëve të Brendshme, Fejzi Alizoti për princ Vidin, 12 mars 1914.

[65] *HHSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-41-4172, Raport i këshilltarëve të kabinetit të Vidit, Buhberger dhe Kastold për ministrat e Jashtëm austriak dhe italian, Durrës, 14 mars 1914.

[66] *AQSH*, F. 694, V. 1914, D. 246(6), fl. 5, Telegram i drejtorit të Përgjithshëm të Punëve të Brendshme, Fejzi Alizoti për princ Vidin, 12 mars 1914; *HHSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-41-4172, Raport i këshilltarëve të kabinetit të Vidit, Buhberger dhe Kastold për ministrat e Jashtëm austriak dhe italian, Durrës, 14 mars 1914.

[67] *HHSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-41-4172, Raport i këshilltarëve të kabinetit të Vidit, Buhberger dhe Kastold për ministrat e Jashtëm austriak dhe italian, Durrës,14 mars 1914

[68] *Po aty*, Vj. 24-7-728, Telegram i Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë për ambasadorit e saj në Athinë, Vjenë, 4 mars 1914; *Po aty,* Vj. 24-14-1444, Raport i Konsullatës së Përgjithshme të Austro-Hungarisë në Janinë për Ministrinë e Jashtme, Janinë, 22 mars 1914; *Po aty*, Vj. 24-6-671, Raport i konsullit të Përgjithshëm të Austro-Hungarisë në Janinë, Kral për Ministrinë e Jashtme, Gjirokastër, 27 mars 1914.

Burime nga terreni konstatojnë se "Lëvizja Vorioepirote" u shfaq më fort atje ku ajo u ndihmua nga asistenca e trupave grekë[69]. Oficerë dhe ushtarë të ushtrisë grekë vazhduan ta simpatizonin dhe ndihmonin Lëvizjen. Oficerë të shumtë vazhduan të dezertonin dhe grupe andartësh mbërritën në Shqipëri. Nga Konsullata e Përgjithshme e Austro-Hungarisë në Selanik njoftohej se "trupat e rregullt grekë nga garnizonet rreth Follorinës po dezertonin nga ushtria greke dhe bashkë me armatime po i bashkëngjiteshin asaj epirote"[70]. Në telegramin që mitropoliti i Korçës i dërgoi homologut të tij në Durrës, pohoi se "epirotët " ishin përforcuar në mënyrë të konsiderueshme me anën e trupave të rregullt grekë[71]. Një pjesë e konsiderueshme e armëve i ishin marrë ushtrisë së rregullt greke, që nuk kishte bërë rezistencë, pavarësisht urdhrave të lëshuar nga qeveria[72]. Në fund të marsit 1914, pretendohet se "kryengritësit kishin në dispozicion katër bateri artilerie mali, treqind artileri të ushtrisë greke, 37 oficerë grekë të dezertuar dhe 20.000 deri 25.000 njerëz të armatosur"[73].

Si të mos mjaftonin këto, javën e tretë të marsit 1914, evakuimi i ushtrisë greke u ndërpre zyrtarisht[74]. Ministri i Jashtëm grek njoftoi ambasadorët e Fuqive të Mëdha në Athinë mbi pezullimin e zbrazjes. Ai e justifikonte ndërprerjen e evakuimit me faktin se, në "tokat e Korçës të zbrazura nga ana greke kishin hyrë banda shqiptare, të cilat kishin bërë dëme të tmerrshme"[75]. Për organet qeveritare greke, rifillimi i tërheqjes duhej të bëhej në kushte të reja. Ushtria greke nuk duhej t'ia dorëzonte xhandarmërisë shqiptare me procesverbal territoret që zbrazte. Ajo vetëm duhej ta njoftonte atë për tërheqjen. Kjo mënyrë tërheqjeje, praktikisht e bënte të pamundur vendosjen e forcave shqiptare në tokat e zbrazura.

[69] *Po aty*, Vj. 24-7-728, Telegram i Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë për ambasadorit e saj në Athinë, Vjenë, 4 mars 1914.

[70] *AIH*, A-V-212, fl. 65-67; *HHSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-7-738, Raport i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Athinë për ministrin e Jashtëm, Athinë, 6 mars 1914.

[71] *AIH*, A-VI-39, viti 1913-1914, fl. 133, Telegram i ambasadorit të Britanisë së Madhe në Vjenë për ministrin e Jashtëm, Grej, Vjenë, 4 prill 1914.

[72] *AMAE* në *AIH*, F. 150, fl. 484, Raport i konsullit francez në Korfuz për Ministrinë e Jashtme, Korfuz, 4 prill 1914.

[73] *Po aty.*

[74] *AMAE* në *AIH*, F. 149, fl. 286, Telegram i Ministrisë së Jashtme të Greqisë për legatën e saj në Paris, Athinë, 22 mars 1914.

[75] *AIH*, A-IV-330, fl. 99.

Territoret, pasi të zbrazeshin nga ushtria greke, do të pushtoheshin menjëherë nga ajo "epirote", ashtu sikurse kishte ndodhur. Nuk kaloi shumë kohë dhe filluan përleshjet e armatosura mes xhandarmërisë shqiptare dhe së ashtuquajturës ushtri epirote. Më 19 mars 1914, dorëzimi i fshatit Odriçan nga ushtria greke pa procesverbal, shënoi edhe përplasjen e parë të armatosur mes tyre[76]. Me kalimin e kohës, përleshjet e armatosura mes bandave dhe xhandarmërisë shqiptare, në ndihmë të së cilës u vunë edhe çetat shqiptare, u intensifikuan[77]. Fati i Shqipërisë dukej më i zi, pikërisht atëherë kur kujtohej se kishte arritur dita e lumturisë dhe e lirisë[78].

E shqetësuar nga informacioni që i vinte nga terreni, qeveria shqiptare u dërgoi më 25 mars 1914 një notë Fuqive të Mëdha. Aty ajo vinte në pah faktin se qeveria greke nuk ishte e sinqertë në plotësimin e angazhimeve të marra përpara Evropës. Nëpërmjet notës, qeveria greke akuzohej nga homologia shqiptare se "nga njëra anë i tërheq trupat e saj nga krahinat që duhen boshatisur, nga ana tjetër, madje edhe më parë se këta trupa të jenë larguar nga tokat e pushtuara, dërgon atje banda komitësh të rekrutuara midis llumit të popullsisë dhe midis ushtarëve më të përshtatshëm për të zhvilluar guerilen"[79]. Akuzat vijonin edhe me punën që autoritetet greke bënin në organizimin, armatosjen dhe mbajtjen e bandave. Vihej në dukje zbrazja tejet e ngadaltë, e cila patjetër që do të sillte shkeljen e afatit të tërheqjes, të caktuar nga Fuqitë e Mëdha. Ecuria e tërheqjes kishte përkeqësuar gjendjen në Shqipërinë e Jugut duke vështirësuar e vënë në rrezik jetën e banorëve. Qeveria shqiptare tërhoqi vëmendjen e Fuqive mbi mizoritë që po kryheshin në Jug nga bandat greke. Sipas saj, ato duke marrë zemër nga qëndrimi i autoriteteve greke, "kanë vrarë mjaft xhandarë shqiptarë". Qeveria shqiptare nuk pranonte asnjë përgjegjësi për atë çka mund të ndodhte aty dhe për të përligjur sa më lart, e shoqëroi notën me një shtojcë prej tetë telegramesh të mbërritura nga terreni në Ministrinë e Brendshme dhe të Luftës[80].

---

[76] *Po aty*, fl. 115.

[77] Për aksionin e çetave shqiptare kundër forcave "vorioepirote" shih: Arben Puto, *Shqipëria Politike, 1912-1939*, Tiranë: "Toena", 2009, f. 134-136.

[78] Mehdi Frashëri, *Kujtime (vitet 1913-1933)*, Tiranë: "OMSCA-1", 2005, f. 9.

[79] *HHSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-41-4164, Notë e qeverisë shqiptare drejtuar Fuqive të Mëdha, Durrës, 25 mars 1914.

[80] *Po aty*, Shtojcë e notës së qeverisë shqiptare drejtuar Fuqive të Mëdha, Durrës, 25 mars 1914.

Dyshime për sinqeritetin e Greqisë u shfaqën edhe nga delegatë të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit. Ata besonin në një politikë fasadë të përdorur prej qeverisë greke, e cila kishte si qëllim të maskonte vazhdimin e politikës aktive në dobi të çështjes kombëtare greke[81].

Nota e qeverisë shqiptare u prit me pakënaqësi në Greqi. Pavarësisht shqetësimeve që ajo ngrinte, qeveria greke deklaroi se, e kishte dhënë me kohë urdhrin e evakuimit dhe vazhdoi të insistonte në besnikërinë e saj ndaj Evropës. Ajo akuzoi qeverinë shqiptare për keqtrajtimin që trupat e saj po i bënin popullsisë "epirote", dhe ngarkoi përfaqësuesit e grekë pranë Fuqive të Mëdha që të protestonin ndaj këtyre veprimeve[82]. Deklarata e qeverisë greke u përforcua edhe nga princi Andrea, sipas të cilit "qeveria greke ishte prekur në sedër nga nota, e cila ishte e zhveshur nga çdo pretendim me vlerë"[83].

Ngjarjet dramatike të Korçës

Korça konsiderohej një qytet i rëndësishëm për "Lëvizjen Vorioepirote", e cila e synonte atë "për ta bërë kryeqytet të Epirit Autonom"[84]. Situata në qytet dhe zonat përreth ishte e acaruar si rezultat i propagandës greke, e cila vazhdonte të ishte nxitëse dhe e fuqishme. Propaganda drejtohej nga krerët më të lartë të kishës, ku rol parësor kishte mitropoliti i Korçës dhe Konicës, Jermanos. Ai mbështeste hapur "Lëvizjen Vorioepirote", kundërshtonte bashkimin e territoreve jugore me shtetin shqiptar, duke qenë kështu një rrezik real për paqen në rajon[85]. Kishte bërë gjithçka ishte e mundur për të krijuar ndonjë incident, që mund të shërbente si pretekst për rikthimin e trupave grekë në qytetin juglindor[86]. Mbante kontakte të vazhdueshme me oficerë grekë në

[81] *AMAE* në *AIH*, F. 149, fl. 190-196, Raport i konsullit të Francës në Korfuz për Ministrinë e Jashtme, Korfuz, 14 mars 1914.

[82] *HHSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-14-1453, Raport i atasheut ushtarak të Marinës së Austro-Hungarisë në Athinë për shefin e Shtabit të Përgjithshëm, Athinë, 10 prill 1914.

[83] *AMAE* në *AIH*, F. 150, fl. 484, Raport i konsullit të Francës në Korfuz për Ministrinë e Jashtme, Korfuz, 4 prill 1914.

[84] *Po aty*, F. 149, fl. 414, Raport i konsullit të Francës në Korfuz për ministrin e Jashtëm, Dumerg, Korfuz, mars 1914.

[85] *AQSH*, F. 70, D. 15, fl. 10, Raport telegrafik i majorit Shnellen për ministrin e Brendshëm, Esat Toptani, Korçë: 22 mars 1914.

[86] J. Swire, *Shqipëria: Ngritja e një...,* f. 170.

pension, të njohur në Korçë si profesorë të liceut grek; me popullsinë progreke të qytetit; me homologun e tij në Selanik dhe ish-deputetin grek në Parlamentin osman G. Bushos, i emëruar nga "qeveria e Epirit Autonom" si prefekt i Korçës. Ky i fundit luajti një rol shumë të rëndësishëm në trazirat që po përgatiteshin në Korçë[87].

Divizionet e ushtrisë greke, në largim e sipër nga Korça, kishin lënë në spital një numër ushtarësh, nën pretekstin se ata kishin nevojë për trajtim të mëtejshëm mjekësor. Ky kontingjent ishte bërthama e trazirës natën e 2 prillit të vitit 1914. Të përforcuar nga kontingjente të ushtrisë greke të ardhura nga përtej kufirit dhe batalionet "epirote", ata sulmuan me armë xhandarmërinë e qytetit[88]. Të gjitha dëshmitë e mbledhura nga oficerët holandezë, robërit e kapur nga xhandarmëria shqiptare dhe, pak kohë më vonë nga administrata franceze, treguan qartë se, batalionet e njohura si epirote ishin formuar nga ushtarë të rregullt grekë dhe andartë nga Kreta[89]. Që në mes të marsit 1914, bateria e ushtrisë greke që ishte tërhequr nga Korça në Janinë, kishte lëvizur mbrapsht në drejtim të Konicës. Konsulli austro-hungarez i Janinës, vinte në pah se, në këtë periudhë guvernatori i Përgjithshëm i Janinës, Angjelos Forestis (Angelos Forestis) e kishte pakësuar rreptësinë ndaj Lëvizjes Autonomiste[90], ndërsa Athina kishte ndërprerë lidhjen telegrafike me Korçën, duke i shkaktuar vështirësi komunikimi xhandarmërisë shqiptare, me qendrën në Durrës[91]. Reparte të ushtrisë greke, që gjendeshin në Bilisht, paguanin dhe organizonin banda në Bozhigrad e rrotull tij. Andartët nën drejtimin e kapitenit të ushtrisë greke, Melas, kishin pushtuar Leskovikun dhe vijën e lumenjve Poda-Lengarica[92].

---

[87] *AIH*, A.IV.212, fl. 91.

[88] *Ethnic Minorities in the Balkan Studies*, 1860-1971, Volume 3, 1914-1923, Editor Bejtullah Destani, Archive Edition, 2003, Raport i delegatit britanik në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, H. Lemb (Harry Lamb) për Ministrinë e Jashtme, Vlorë 3 prill 1914; *HHSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-3-371, Telegram i të ngarkuarit të Austro-Hungarisë në Durrës për Ministrinë e Jashtme, Durrës, 15 mars 1914.

[89] Jacques Boucart, *Shqipëria dhe shqiptarët*, Tiranë: "Dituria", 2004, f. 103.

[90] *HHSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-7-762, Raport i konsullatës së Austro-Hungarisë në Janinë për Ministrinë e Jashtme, Janinë, 15 mars 1914.

[91] *AQSH*, F. 694, V. 1914, D. 246(6), fl. 9, Telegram i gjeneralit të detit për kancelarinë princore (qeverinë shqiptare) në Durrës, 19 mars 1914.

[92] *Po aty*, F. 70 (Esat Toptani), D. 15, fl. 10, Raport telegrafik i majorit Shnellen për ministrin e Brendshëm, Esat Toptani, Korçë, 22 mars 1914.

Deponimet e 4 ushtarëve grekë, të zënë robër në Korçë dhe të protokolluara nga majori holandez, G. Shnellen, më 11 dhe 13 prill 1914, evidentuan qartë rolin e ushtrisë së rregullt greke në ngjarjen e Korçës[93]. Ushtarët deponuan se, ishin "pjesëtarë të trupave të rregullt grekë, që shkonin në aksion për të ruajtur kufirin shqiptar". Ishin nga Kreta dhe Traka. Bënin pjesë në kompaninë e nëntogerit Sterios, e cila përbëhej nga rreth 350 veta, "të gjithë ushtarë të rregullt grekë dhe pak vullnetarë". Një pjesë e ushtarëve kishin qenë pjesë e divizioneve të Korçës gjatë okupacionit grek. Pjesa tjetër ishte marrë nga Selaniku. Takimi i tyre ishte bërë në Follorinë, prej nga ishin nisur për në Bilisht, ku ishin organizuar në grupe më të vogla. Nga Bilishti kishin hyrë në Korçë, ku ishin bashkuar me kontingjentin e ushtarëve grekë, që gjendeshin në spitalin e qytetit. Ata drejtoheshin nga kolonelë dhe togerë të ushtrisë greke. Ishin të armatosur me mauzerë dhe maliherë prej trupave ndihmës grekë dhe kishin me vete edhe mitraloza, të cilët i kishin marrë nga Selaniku[94]. Përgjegjësia e ushtrisë greke në organizimin e grushtit të shtetit ishte kështu e dukshme. Greqia vazhdonte të mos respektonte kufirin jugor shqiptar, duke shkelur sovranitetin e shtetit shqiptar. Ajo po tregonte se, jo vetëm mbështeste qëndrimet e qeverisë së Vorio-Epirit, por kërkonte edhe përfshirjen e Korçës në përbërje të krahinës autonome[95].

Fillimisht aksioni pati sukses dhe brenda pak orësh ndërtesat publike dhe pikat e tjera kyçe të qytetit ranë në duart e ushtarëve grekë. Më 2 prill, prefekti i sapoemëruar i Korçës, Abdyl Ypi, i kërkoi qeverisë shqiptare përforcime[96]. Në pritje të tyre, banorët e qytetit u mblodhën me shpejtësi dhe mbështetën xhandarmërinë, të drejtuar nga komandanti Shnellen dhe kapiteni Dorman. Pas katër ditë luftimesh, më 6 prill, në Korçë u rivendos qetësia. Fajësia e mitropolitit Jermanos u vërtetua dhe komandanti holandez këmbënguli për transferimin e tij në Elbasan, masë kjo e domosdoshme për shpëtimin e qytetit.

Në deklarimet e saj, pas ngjarjeve të Korçës, qeveria greke, ndonëse pranoi dezertimet e shumta në ushtri dhe inkurajimin që prania e trupave

[93] *AIH*, A-IV-66, fl. 67-68. Deponimet e ushtarëve grekë të zënë robër nga majori Shnellen.

[94] *Po aty.*

[95] V. Duka, *Histori e Shqipërisë...,* f. 65.

[96] *AIH*, A-IV-330, fl. 123.

grekë në terren u jepte "epirotëve"[97], shprehej se, ushtria greke nuk kishte qenë aktive në atë që ndodhi në Korçë[98]. Ministri i Jashtëm Streit (Georgios Streit), ndonëse deklaronte domosdoshmërinë e ushtrimit të kontrollit energjik ndaj ushtrisë greke, shtonte se, qeveria e tij e kishte të pamundur të vepronte ashpër ndaj saj, për shkak të presionit të opozitës[99]. Dështimi i grushtit të shtetit shkaktoi dëshpërim dhe nervozizëm në opinionin publik grek[100]. Konsulli austro-hungarez në Athinë mendonte se, ngjarja e mësipërme "do t'u tregonte epirotëve se xhandarmëria shqiptare nuk ishte në sasi të papërfillshme dhe se ky sukses i saj do ta sillte në vete Zografosin"[101].

Acarimi i marrëdhënieve shqiptaro-greke: shpallja e mobilizimit të përgjithshëm

Në përpjekje për të reaguar ndaj situatës në Jug, më 3 prill 1914, Vidi shpalli mobilizimin e përgjithshëm për të gjithë meshkujt nga 21 deri në 49 vjeç[102]. Fillimisht, ai mendoi të vendosej vetë në krye të trupave që do të niseshin në Jug, por duket se shpejt ndryshoi mendje dhe vendosi ministrin e Brendshëm dhe të Luftës, Esat Toptanin[103]. Shpallja e mobilizimit shqetësoi Fuqitë e Mëdha dhe Greqinë. Duke menduar inferioritetin e forcave shqiptare, gjendjen e dobët financiare të shtetit shqiptar dhe rrezikun e ndërlikimeve me fqinjët, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit iu kundërvu fort masave ushtarake[104]. Nga ana tjetër, qeveria greke kërcënoi se, çdo veprim i rregullt ushtarak nga

---

[97] *HHSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-3-372, Telegram i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Athinë për ministrin e Jashtëm, Athinë, 5 prill 1914.

[98] *Po aty*, Vj. 24-18-1847, Raport i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Athinë për Ministrinë e Jashtme, Athinë, 11 prill 1914.

[99] *Po aty.*

[100] *Po aty*, Vj. 24-14-1453, Raport i atasheut ushtarak të Marinës së Austro-Hungarisë në Athinë për shefin e Shtabit të Përgjithshëm, Athinë, 10 prill 1914; *po aty*, Vj. 24-18-1847, Raport i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Athinë për Ministrinë e Jashtme, Athinë, 11 prill 1914.

[101] *AIH*, A-IV-330, fl. 127.

[102] *AMAE* në *AIH*, F. 150, fl. 611-614, Raport i konsullit francez në Korfuz për kryeministrin dhe ministrin e Jashtëm, Dumerg, Korfuz, 11 prill 1914.

[103] V. Duka, *Histori e Shqipërisë...,* f. 68.

[104] J. Swire, *Shqipëria: Ngritja e një...,* f. 172.

qeveria shqiptare do të çonte në luftë me të[105]. Në këtë moment, sistemi i spiunazhit grek u vu në lëvizje. Ai ishte i mirorganizuar dhe tepër aktiv, veçanërisht në Durrës, ku ishte edhe qendra e administratës qeverisëse shqiptare dhe ishte vendosur trupi diplomatik. Ky sistem drejtohej nga shpirti i propagandës greke, mitropolit Jakovi (Jakovos Ngjingjilas). Me të bashkëpunoi edhe delegat special i qeverisë greke, Varatasi (Kostandinos Baratasis), i cili vizitoi shpesh selinë e Mitropolisë në Durrës[106]. Të dy vlerësonin Esat Toptanin, ndikimin dhe autoritetin e të cilit, e shihnin si e vetmja gjë reale dhe e mundshme në Shqipëri[107].

Ministri Toptani, në dukje tregoi interes të veçantë për mobilizimin e përgjithshëm. Por, Princi mendonte se, ai kishte dhënë fshehurazi kundër urdhra, gjë të cilën ai mund ta bënte me lehtësi në postin që mbante[108]. Për të përballuar situatën e vështirë në Shqipërinë e Jugut, qeveria shqiptare kishte hyrë në bisedime me Austro-Hungarinë dhe Italinë për të blerë armë dhe municione lufte. Ato pritej të mbërrinin në Durrës në fillim të prillit, prej nga ku do të dërgoheshin në Tiranë, e cila ishte edhe qendra e mobilizimit. Nga Tirana armët do të niseshin për në Korçë, ku edhe do të nisnin veprimet ushtarake për të asgjësuar "ushtrinë epirote". Pritej që këto veprime të zgjasnin nga 15 ditë deri në një muaj[109]. Por, si ushqimet, ashtu dhe municionet e pakta që mbërritën në Durrës, nuk arritën të shkonin në Korçë, ndonëse shqiptarët që u bënin qëndresë "epirotëve" vuanin nga armatimi jo i përshtatshëm dhe mungesa e ushqimeve. Një pjesë e konsiderueshme e tyre mbeti në Durrës e Tiranë dhe u shpërnda fshehurazi te përkrahësit e Esatit[110]. Pretendohet se, ministri Toptani i la me qëllim punët të keqësoheshin në Shqipërinë e Jugut, sepse nuk donte të armiqësohej as me qeverinë greke dhe as me ata shqiptarë, që ishin rreshtuar në krah të saj[111]. Duke menduar veten si princ të Shqipërisë në të ardhmen, ai nuk dëshironte të kishte konflikte të

[105] *Po aty.*

[106] *AMAE* në *AIH*, F. 149, fl. 190, Raport i konsullit të Francës në Korfuz për kryeministrin dhe ministrin e Jashtëm, Dumerg, Korfuz, 14 mars 1914.

[107] *Po aty,* F. 149, fl. 29, Aneks i raportit të konsullit të Francës në Korfuz për kryeministrin dhe ministrin e Jashtëm, Dumerg, Korfuz, 4 mars 1914.

[108] *AIH*, A-IV-66, fl. 12.

[109] *HHSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-41-4143, Telegram nga Ministria e Jashtme e Austro-Hungarisë nuk dihet se për kë, Vjenë: 8 prill 1914.

[110] Skënder Luarasi, *Kolonel Tomson*, Shtypshkronja Gutemberg, 1934, f. 14-15.

[111] V. Duka, *Histori e Shqipërisë...,* f. 68.

hapura në Jug. Ministri u konsiderua përgjegjës, kur u njoftua se ish-rezervistët e tij kishin sulmuar grupet e malësorëve nga Veriu, që po marshonin në ndihmë të bashkatdhetarëve të tyre në Jug[112].

Debate të ashpra u zhvilluan mes tij e oficerëve holandezë, të cilët e fajësuan atë për vështirësitë që po u shkaktonte në organizimin e xhandarmërisë dhe vullnetarëve. Të njëjtin qëndrim mbajti edhe opinioni publik. Prej shumë anëve erdhën lajme për t'u ruajtur prej E. Toptanit, i cili akuzohej për marrëdhënie me grekët, për bashkëfajësi në ngjarjet e Jugut dhe për kundërshtimin e formimit të milicisë[113]. Ministri u akuzua për marrjen e financimeve nga fqinji i Jugut, për të penguar operacione të efektshme në Shqipërinë e Poshtme[114]. Metodat e përdorura prej tij nuk bënë gjë tjetër veçse thelluan përçarjen në vend, duke shtuar vështirësitë për qeverinë shqiptare. Në atë situatë të turbullt, qeveria e Durrësit shfaqi mosbesimin e saj edhe karshi delegatit grek, Varatasi. Nga konsulli francez në Korfuz, pretendohet se, ai ndihmohej në punën e tij jo vetëm nga Jakovi, por edhe nga Esat Toptani[115].

Mobilizimi ushtarak shfaqi probleme dhe një pjesë e konsiderueshme e shqiptarëve kundërshtoi të nisej për në Jug[116]. Agjentë aktivë, të paguar nga Greqia, kishin arritur të bindnin një pjesë të tyre të mos i përgjigjeshin thirrjes për vullnetarë[117].

---

[112] J. Swire, *Shqipëria: Ngritja e një...,* f. 171.

[113] *AIH*, A-IV-66, fl. 12.

[114] *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), viti 1920, dos. 31, fl. 126. Materiali është një ditar i shkruar me shkrim dore në një fletore me 67 faqe. Emri i atij që e ka mbajtur nuk jepet, por kuptohet se ai është një protagonist i ngjarjeve në Shqipëri nga viti 1914 deri në vitin 1920. Në lidhje me Esatin, ditarshkruesi shënon se Pando Vangjeli i kishte thënë: "Mësova nga një burim krejt i sigurt qysh e paguanin grekt shërbimin që i pat bërë Esati duke mos dërguar ushtri e xhepane në Korçë në vitin 1914. Varatasi i paska dhuruar së shoqes t'Esatit një gjerdan 300.000 fr". Financimet që Esat Toptani merrte nga grekët evidentohen edhe nga: J. Swire, *Shqipëria: Ngritja e një...,* f. 171; A. Puto, *Shqipëria Politike...*, f. 142.

[115] *AMAE* në *AIH*, F. 150, fl. 611-614, Raport i konsullit francez në Korfuz për kryeministrin dhe ministrin e Jashtëm, Dumerg, Korfuz, 11 prill 1914.

[116] Për vështirësitë dhe problemet në rekrutimin e popullsisë shih, *AQSH*, Fondi 486, viti 1914, dos. 679, Telegrame nga Prefektura e Elbasanit për Ministrinë e Brendshme dhe të Luftës, fl. 37, 40, 76, 78, 118, 120, 264, 284.

[117] J. Swire, *Shqipëria: Ngritja e një...,* f. 173.

Gjatë muajit prill, përplasjet mes xhandarmërisë shqiptare dhe batalioneve epirote u intensifikuan. Sipas majorit holandez Shnellen, situata në zonat juglindore ishte bërë shumë e vështirë[118]. Frika për rikthimin e ushtrisë greke ishte e madhe[119]. Në të gjithë zonën ishin shpërndarë armë dhe veshje për mbështetësit e çështjes greke. Numri i andartëve të mbërritur nga Greqia, ishte rritur. Mitropoliti dhe shefi i policisë së Kastoriasë (Kosturit), paguanin gjithçka dhe ushtria greke mbështeste haptazi sulmet në afërsi të Leskovikut. Në këtë situatë, mendohej se, ishte marrëzi përpjekja e xhandarmërisë shqiptare për të marrë në zotërim Bilishtin dhe zonat përreth, sepse ajo zotëronte forca të pakta dhe të dobëta ushtarake.

Ishte e vështirë të orientoheshe në një situatë kaq të vështirë, shprehej anëtari rus i Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit[120]. Ankoheshin njëherazi si qeveria shqiptare, ashtu edhe ajo greke. Ndërsa, qeveria greke, ankohej për veprime të kryera nga njësitë shqiptare në zonat jugore, ankesa për veprime të ngjashme, të kryera nga ushtria greke, vinin nga të gjitha anët e Shqipërisë[121]. Sipas tyre, grekët në largim e sipër digjnin fshatrat dhe ushtronin dhunë mbi popullsinë shqiptare myslimane. Tejet agresive ishte veçanërisht sjellja e bandave që kishin në përbërje të tyre kretanë. Një pjesë e konsiderueshme e fshatrave të prefekturës së Gjirokastrës, Leskovikut, Skraparit e Korçës u dogjën e u rrënuan plotësisht, ndërsa një pjesë e madhe e popullsisë, veçanërisht asaj myslimane, u masakrua[122]. Qytetet e Tepelenës dhe të Leskovikut u

[118] *HHSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-41-4145, Letër e majorit Shnellen për gjeneralin De Ver (De Veer), Korçë, 14 prill 1914.

[119] *AQSH*, F. 145 (Qeveria e Përkohshme e Vlorës), V. 1914, D. III-8/1, fl. 584-585, Telegram i prefektit të Korçës, Abdyl Ypi për ministrin e Brendshëm, Esat Toptani, Korçë, 15 prill 1914.

[120] *Po aty*, F. 486 (Koleksion fondesh personale, 1913-1944), V. 1914, D. 571, fl. 70-72, Raport i delegatit rus në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për Ministrinë e Jashtme, Vlorë: 15 prill 1914.

[121] *Po aty*, F. 486, V. 1914, D. 571, fl. 70-72, Raport i delegatit rus në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për Ministrinë e Jashtme, Vlorë, 15 prill 1914.

[122] Një ngjarje që tronditi tërë opinionin e kohës ishte masakra në Hormovë dhe Kodër afër Tepelenës. Për më shumë shih: Mid'hat Frashëri, *Çështja e Epirit*, Tiranë: "Lumo Skëndo", 1998, Raport lidhur me masakrat e kryera në fshatin Kodër, Kodër, 29 prill 1914; J. Swire, *Shqipëria: Ngritja e një...,* f. 185-189; *AMPJ*, viti 1948, dos. fl.136, Studim për Shqipërinë e Jugut, fl. 27-47.

shkatërruan[123]. Në Vlorë dhe Berat nisën të mbërrijnë refugjatë nga Tepelena dhe Gjirokastra.

Pavarësisht se, zyrtarë të lartë grekë nuk pranuan përgjegjësinë e drejtpërdrejtë në përvijimin e kësaj politike, është e vështirë të mos i bësh ata përgjegjës. Emigrimet masive dhe dhuna e skajshme ndaj popullsisë kryesisht asaj myslimane shoqëruan dukshëm procesin e krijimit të zonave të pastra nga pikëpamja fetare, që sipas konceptit grek të kombësisë, nënkuptonte pastërti edhe etnike. Ky proces u ndoq nga ushtritë ndërluftuese dhe mbështetësit e tyre në të gjithë gadishullin e Ballkanit, gjatë Luftërave Ballkanike. Vështirë të besohet se, një politikë e tillë ishte lokale, spontane dhe rastësore. Duke përjashtuar këtu ekzagjerimin e zbatimit në terren, ajo ishte një ndërmarrje e gjerë, që sigurisht bëhej me mbështetjen e politikës.

Ushtria greke në Maqedoni bëri po atë që "ushtria epirote" bëri ndaj shqiptarëve myslimanë në Shqipërinë e Jugut. Ushtria osmane në Egje apo gjetkë u soll në të njëjtën mënyrë me popullsinë e krishtere greke. Zona të tëra u dogjën, popullsia u masakrua dhe u detyrua të migrojë[124]. Në Shqipërinë e Jugut, në zonën e Tepelenës, të Këlcyrës, të Ersekës dhe të Korçës, gati 250 fshatra u dogjën, me dhjetëra të tjera u rrënuan e u plaçkitën. Disa mijëra njerëz u vranë në luftime ose poshtërisht, përfshirë në to gra dhe fëmijë[125]. Rreth 150.000 burra, gra dhe fëmijë u larguan nga shtëpitë e tyre. Në korrik, vetëm në Vlorë ndodheshin rreth 100.000 refugjatë shqiptarë[126]. Kostoja njerëzore dhe materiale për shqiptarët dhe qeverinë e tyre të ardhshme, ishte e lartë. Në maj 1914, konsulli francez në Korfuz shprehej se "eksodi i popullsisë së krishterë dhe myslimane ka përpjesëtime të gjera. Popullsitë janë tërhequr në krahinat malore dhe janë katandisur në një gjendje shkatërrimi të plotë. Rreth 40 familje kanë

[123] J. Boucart, *Shqipëria dhe ...,* f. 103.

[124] *Ethnic Minorities in the Balkan Studies...,* fl. 9-10. Raport i ministrit britanik në Athinë për Ministrinë e Jashtme, Athinë, 18 prill 1914 (Trajtimi i popullsisë myslimane në Maqedoni nga administrata greke); fl. 63-66. Raport i ministrit britanik në Stamboll për Ministrinë e Jashtme, Stamboll, 6 maj 1914 (Emigrimi i popullsisë myslimane nga Maqedonia dhe i popullsisë ortodokse nga Thraka); fl. 138-143. Raport i zv. konsullit britanik në Manastir për Ministrinë e Jashtme, Manastir, 25 maj 1914 (Emigrimi i popullsisë myslimane dhe sjellja e grekëve ndaj saj).

[125] Mid'hat Frashëri, *Çështja e Epirit,* Tiranë: "Lumo Skëndo", 1998*,* f. 80.

[126] J. Swire, *Shqipëria: Ngritja e një...,* f. 189.

zbarkuar në Korfuz. Një numër i madh fshatrash janë shkatërruar. Fund e krye vendi ka një pamje të mjeruar. Do të duhen përpjekje të konsiderueshme dhe dhjetëra milionë për të sjellë aty begatinë"[127]. Njëherazi, trauma psikologjike që përjetoi popullsia e këtyre zonave, la gjurmë të thella në memorien historike të tyre. Nga ana tjetër, sjelljet mizore të kësaj kohe kushtëzuan edhe në të ardhmen marrëdhëniet shqiptaro-greke[128].

Në një diskutim në Dhomën e Komuneve, koloneli Aubrey Herbert akuzoi drejtpërsëdrejti qeverinë greke për situatën e krijuar: "Unë e akuzoj qeverinë greke për bashkëpunim në këto vrasje. E akuzoj atë për bashkëpunim me makinerinë që ka prodhuar këto rezultate"[129]. Po në të njëjtin diskutim, e në të njëjtën foltore numri një i diplomacisë britanike, E. Grei (Edward Grey) deklaroi se "ndonëse jam i bindur se Venizelosi dëshiron sinqerisht t'i parandalojë ndodhi të tilla, fakti që ato u detyrohen grekëve, sado që të jenë të papërgjegjshëm, duhet të krijojnë një përshtypje shumë të pafavorshme për qeverinë greke"[130].

Në këtë situatë të vështirë, rrezja e kontaktit mes shqiptarëve dhe grekëve ishte zvogëluar dhe marrëdhëniet mes tyre nuk mund të ishin veçse të vështira dhe tejet të acaruara.

S u m m a r y

THE ALBANIAN PRINCIPALITY AND THE ATTITUDE OF GREECE
(MARS – APRIL 1914)

On July 29th 1913, the Conference of London declared Albania as an autonomic principality, inherited sovereignty, under the guarantee of the six Powers. On March 7th 1914, the Prince of Albania, Wilhelm of Wied, arrived in Durrës.

[127] *AMAE* në *AIH*, F. 152, fl. 1251-1257, Raport i konsullit francez në Korfuz për kryeministrin dhe ministrin e Jashtëm francez, Korfuz, 19 maj 1914.

[128] Ledia Dushku, "Sfidat drejt fqinjësisë së mirë", *Studime historike*, Nr. 1-2, Tiranë: 2003, f. 73-74.

[129] J. Swire, *Shqipëria: Ngritja e një...,* f. 186.

[130] *AMPJ*, viti 1948, dos. 136, Raport i Ministrisë së Jashtme shqiptare për Shqipërinë e Jugut dhe marrëdhëniet shqiptaro- greke, fl. 25-29.

The Greek position towards him was conditioned by the position kept by the Great Powers and that of the homologues in the Balkans. In the beginning of March, the Greek Prime Minister admitted that Greece would accept the decision of the Great Powers on Albania. This declaration creates the impression that the Greek government was formally engaged to accomplish its duties towards the Great Powers, by withdrawing its armies from the territories of the Albanian country, within the deadline, and not to support the "Northern Epirus Movement".

The impression created during the first days of March, that the Greek army would withdraw from the Albanian territories quickly and without incidents, did not last long. Declarations and reality were two different things in the relations between the two neighbors, just as they had been in the past. As a result of the tragic events of Korça, the Greek - Albanian correlations deteriorated even more. Greece continued not respecting the southern Albanian border, by violating the sovereignty of the Albanian government.

Meanwhile, violence covered the entire Southern Albania. A considerable number of villages were burnt and destroyed completely, while a large part of the population, especially the Muslims, was massacred. The human and material cost was high for the Albanians and their future government. At the same time, the psychological trauma experienced by the populations of these regions left deep and undeniable traces on their historic memory.

Even if the Greek high officials did not admit their direct responsibility for the organization of this policy, it is difficult not throw responsibility on them. The massive emigration and extreme violence against the population, especially of the Muslim one, evidently accompanied the process of creation of religiously clean areas, which according to the Greek concept, implicated ethnic purity too. This was the process that was followed by the armies and their supporters over the entire Balkans, during the Balkan Wars. It is hard to believe that such policy was local, spontaneous and random. Leaving aside the exaggeration of the application on the field, this policy was a large enterprise, which certainly enjoyed the political support.

Under this difficult situation, the contact between Albanians and Greek was diminished and their relations couldn't but get harsh and extremely aggravated.